



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr. 12-111-6535Q dt. 08.11.2019

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12.2. shkronja d), nenit 73, të Ligjit Nr- 03/L -040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", neni 34 paragrafi 34,6 shkronja g), të Statutit të Komunës së Drenasit të datës 16.09.2008, si dhe të dispozitave të nenit 4,5 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ, Nr-01/2016, për Procedurën e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencave të Komiteteve Konsultative në Komuna, Kuvendi i Komunës së Drenasit, në mbledhjen e rregullore shpalli këtë:

KONKURS PËR FORMIMIN E KOMITETIT KONSULTATIV TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT

1. Kuvendi i Komunës së Drenasit, shpall konkurs publik për formimin e Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore në Komunës së Drenasit si në vijim:
2. Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:
 - 2.1. Kandidati duhet të jetë qytetar i Komunës së Drenasit;
 - 2.2. Të jetë ekspert –përkatësisht njohës i fushës përkatëse;
 - 2.3. Përfaqësimi gjinor në kuotën e 50%.
 - 2.4. Komiteti do të ketë pesë anëtar.
3. Kriteret për përzgjedhje:
 - 3.1. Diplomë Universitare;
 - 3.2. Njohës i mirë i fushës përkatëse ose anëtar i organizatës, e cila merret me lëmin përkatëse;
 - 3.3. Të ketë aftësi komunikuese;
 - 3.4. Të ketë aftësi ofrimi të njohurive në çështjet gjinore;
 - 3.5. Motivues i punës ekipore në mënyrë efektive.
4. Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Komiteteve konsultative:
 - 4.1. Dhënia e propozimeve të rregulloreve të ndryshme në përfshirjen e perspektivës gjinore;
 - 4.2. Hulumtime të ndryshme, mendime dhe ide rreth iniciativave të ndërmara nga Kryetari i Komunës, Komitetet e përhershme apo Kuvendi i Komunës në fushën perspektivës gjinore;
 - 4.3. Paraqitja e pikëpamjeve dhe mendimeve të qytetarëve te Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës;

4.4. Propozime për zgjidhjen e problemeve të identifikuara në baza gjinore;

5. Mandati i anëtarëve:

Mandati i anëtarëve të Komitetit konsultativ është 4 (katër) vjeçar, nga dita e emërimit, me të drejtë të rizgjedhjes edhe për një mandat të dytë.

6. Për punën që do ta kryejnë anëtarët e komiteve konsultative do të kompensohen nga **50€**, për çdo mbledhje që do ta mbajnë, anëtarët e komitetit konsultativ nuk mund të kompensohen për më shumë se gjashtë (6) mbledhje të cilat mbahen brenda vitit.

7. Dokumentet e kërkuara:

- 7.1 Diploma universitare;
- 7.2 CV personale;
- 7.3 Certifikata e lindjes;
- 7.4 Vërtetimin që nuk është nën hetime;
- 7.5 Kopja e letërnjoftimit.

8. Afati i konkursit:

8.1. Konkursi është i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) nga data 08.11.2019 deri me 22.11.2019.

8.2. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën për ofrimin e shërbimeve të qytetarëve ose përmes postës në adresën: Komuna e Drenasit rruga „Fehmi e Xhevë Lladrovci.

Drenas; 08.11.2019.

Kryesuesi i KK-së;
z. Labinot Halilaj

